

SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA

KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së
ŽALBENO VEĆE KAI

GSK-KPA-A-146/14

Prishtinë

25 prill 2018

Në çështjen juridike të

K. së P.

Përfaqësuar nga X. R.

Pala ankuese

kundër

R.R. I.

Pala përgjegjëse në ankesë

Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës, i përbërë nga Beshir Islami, Kryetar i Kolegjit, Krassimir Mazgalov dhe Ragip Namani, anëtarë, duke vendosur rreth ankesës kundër Vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/219/2013, të datës 27 nëntor 2013, (lënda e regjistruar në AKP me numrin KPA38108, KPA38109 dhe KPA38110), pas shqyrtimit të mbajtur më 25 prill 2018 mori këtë:

AKTGJYKIM

1. Ankesat e paraqitura nga K. e P., të regjistruara me numrat GSK-KPA-A-146/2014, GSK-KPA-A-147/2014 dhe GSK-KPA-A-148/2014, bashkohen në një lëndë të vetme me numrin GSK-KPA-A-146/2014.
2. Ankesat e paraqitura nga K. e P. kundër Vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/219/2013 të datës 27 nëntor 2013, sa i përket kërkesave të regjistruara në AKP me numrat KPA38108, KPA38109 dhe KPA38110, pranohen si të bazuara.
3. Anulohet Vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/219/2013, të datës 27 nëntor 2013, sa i përket kërkesave të regjistruara në AKP me numrat KPA38108, KPA38109 dhe KPA38110.
4. Kërkesat e paraqitura nga R. R.I., të regjistruara në AKP me numrat KPA38108, KPA38109 dhe KPA38110 hidhen poshtë pasi që bien jashtë juridiksionit të Agjencisë Kosovare të Pronës.

Përmbledhje e çështjeve procedurale dhe faktike

1. Më 29 tetor 2007, R.R. I. (më tutje: pala përgjegjëse në ankesë) ka paraqitur tri kërkesa të ndara pranë Agjencisë Kosovare të Pronës (AKP), të regjistruara në lëndën me numrat KPA38108, KPA38109 dhe KPA38110, duke kërkuar vërtetimin e të drejtës së pronësisë dhe ri-posedimin e ngastrës kadastrale nr.231, 232 dhe 233 me sipërfaqe totale prej 02.38.32 ha, të cilat janë bashkuar në një ngastër të re kadastrale me numër 235 dhe me sipërfaqe më të madhe, që ndodhet te Fusha e Livadicës, Komuna e Podujevës (më tutje: prona e kërkuar).
2. Në kërkesa theksohet se pronat e kërkuara qenë humbur për shkak të rrethanave që ndërlikohen me konfliktin e armatosur që ndodhi në Kosovë në vitet 1998/99, duke e cekur 18 qershorin 1999 si datën e humbjes.
3. Për ta mbështetur kërkesën e tij, pala përgjegjëse në ankesë, ndër tjera, në AKP i dorëzoi këto dokumente:

- Aktgjykimin nr.44/95 të lëshuar nga Gjykata Komunale në Kuršumli në 25 mars 1996 me të cilin është shpallur e pavlefshme Kontrata e Shitblerjes e lidhur ndërmjet të ndjerës N. J. dhe Kooperativës Bujqësore “Sloga” (tani “Përparimi”) lidhur me blerjen e pronave të kërkuara më 19 korrik 1967. Kooperativa Bujqësore “Perparimi” në cilësinë e palës përgjegjëse në kërkesë ishte obliguar që pronën e kërkuar t’ua dorëzojë pasardhësve ligjor të ndjerës N. J.
 - Vendimin e Trashëgimisë nr.190/1996 të lëshuar nga Gjykata Komunale e Kuršumlisë më 24 tetor 1996 me të cilin A. I. ishte deklaruar si trashëgimtarja e vetme e nënës së saj - e ndjera N. J., për tërë trashëgiminë, duke përfshirë pronat e kërkuara.
 - Vendimin Kadastral nr.952-02-2/97/123-134 të lëshuar nga Zyra e Gjeodezisë e Republikës së Serbisë, Kadastr i Pronave të Paluajtshme në Podujevë më 4 mars 1997, me të cilin, institucioni i lartcekur ka lejuar që pronat e kërkuara të regjistrohen në emër të A. I.,
 - Certifikatën e vdekjes nr. 1/2000 të lëshuar nga Komuna e Kuršumlisë më 07 shkurt 2000 që tregon se R. I. (bashkëshorti i A. I.) kishte vdekur më 02 shkurt 2000.
 - Certifikatën e vdekjes nr. 412/2002 të lëshuar nga Komuna Kruševcit më 24 prill 2002 që tregon se A. I. (e veja e të ndjerit R. I.) kishte vdekur më 07 prill 2002.
 - Vendimin e Trashëgimisë nr.79/2002 të lëshuar nga Gjykata Komunale e Kuršumlisë më 5 qershor 2002 me të cilin R. I. ishte shpallur si trashëgimtar i vetëm i nënës së tij – të ndjerës A. I., për tërë trashëgiminë duke i përfshirë pronat e kërkuara.
 - Kopjen e Fletës Poseduese nr.160 të lëshuar më 24 korrik 2007 Zyra e Gjeodezisë e Republikës së Serbisë, Kadastr i Pronave të Paluajtshme në Podujevë (e zhvendosur në Kruševac),ku ngastrat kadatrale me numrat 231, 232 dhe 233 ishin regjistruar në emër të A. I. si pronare e vetme.
4. Të gjitha dokumentet e lartcekura janë verifikuar pozitivisht.
 5. Njoftimi fillestar u bë më 07 maj 2008 por më vonë u konsiderua i pasaktë. Më 14 gusht 2013, AKP-ja përsëri i njoftoi kërkesat me numrat KPA38108, KPA38109 dhe KPA38110. Pronat e kërkuara u gjetën të uzurpuara nga Komuna e Podujevës (më tutje: pala ankuese). Përfaqësuesi i palës ankuese e nënshkroi Njoftimin e Pjesëmarrjes dhe pretendoi të drejta ligjore mbi pronat e kërkuara.

6. Brenda afatit ligjor prej 30 ditësh, në përputhje me nenin 10.2 të Ligjit nr. 03/L-079, pala ankuese ka paraqitur përgjigje ndaj kërkesës duke pretenduar se Komuna i ka shpronësuar pronat e kërkuara në mënyrë të ligjshme. Megjithatë, pala ankuese nuk ka paraqitur ndonjë provë në mbështetje të përgjigjes përkitazi me shpronësimin.
7. Sekretaria Ekzekutive e AKP-s i ka gjetur *ex officio* pronat e kërkuara që janë bashkuar në ngastër të re nr.235 me sipërfaqe me të madhe, të evidentuara në emër të palës ankuese.
8. Pala përgjegjëse në ankesë është kontaktuar nga Sekretaria Ekzekutiv dhe ai deklaroi se është duke jetuar në Kuršumli me familjen e tij që nga viti 1967, por kur atij iu kthye prona e kërkuar në bazë të Aktgjykimit të përmendur nr.44/95, ai udhëtoi në Kosovë dhe e shfrytëzoi pronën e kërkuar deri në humbjen e posedimit mbi të njëjtën për shkak të konfliktit të armatosur të viteve 1998-1999.
9. Përmes Vendimit të ankimuar KPCC/D/A/219/2013 të datës 27 nëntor 2013, KPKK-ja i aprovoi kërkesat me numrat KPA38108, KPA38109 dhe KPA38110 me arsyetimin se pala përgjegjëse në ankesë ka vërtetuar të drejtën e tij të pronësisë mbi pronën e kërkuar me dokumente të verifikuara pozitivisht dhe pala ankuese nuk ka arritur të paraqet prova për ta mbështetur pretendimin e tij rreth shpronësimit të pronës.
10. Më 25 mars 2014, Vendimi i KKPK-së i është dorëzuar palës ankuese.
11. Më 22 prill 2014, pala ankuese i paraqiti ankesat e lartcekura.

Pretendimet e palës ankuese

12. Pala ankuese pretendon se vendimi i KKPK-së është marrë me shkelje thelbësore të ligjit në fuqi dhe vërtetim të gabuar të provave të dorëzuara nga pala përgjegjëse në ankesë.

Arsyetimi ligjor

Pranueshmëria e ankesës

13. Ankesat janë parashtruar brenda afatit kohor prej 30 ditëve të paraparë me Ligjin nr. 03/L-079, neni 12.1. Gjykata Supreme ka juridiksion mbi ankesat kundër Vendimit të KKPK-së.

Bashkimi i ankesave

14. Në përputhje me nenin 13.4 të Ligjit nr.03/L-079, Gjykata Supreme mund të vendosë për ankesat e bashkuara apo të shkrira, kur për bashkimin apo shkrirjen e kërkesave është vendosur nga Komisioni, në pajtim me nenin 11.3 (a) të ligjit. Ky nen i mundëson Komisionit që të marrë në konsideratë bashkimin ose shkrirjen e kërkesave me qëllim të shqyrtimit dhe marrjes së vendimeve kur ekzistojnë çështje të përbashkëta ligjore dhe të provave.
15. Dispozitat e Ligjit mbi Procedurën Kontestimore të cilat janë të zbatueshme në procedurën pranë Kolegjit të Apelit të Gjykatës Supreme sipas nenit 12.2 të Ligji nr.03/L-079, si dhe dispozitat e nenit 405.1 në lidhje me nenin 193 të Ligjit Nr. 03/L006 për Procedurën Kontestimore, parashikojnë mundësinë e bashkimit me aktvendim të të gjitha padive nëse ky bashkim i kontribuon efikasitetit dhe ekonomizimit të lëndës.
16. Në tekstin e ankesave të parashtruara nga pala ankuese, Gjykata Supreme konstaton se përveç numrit të ndryshëm të lëndës për të cilën parashtrohet ankesa përkatëse, e gjitha baza faktike dhe ligjore, si dhe çështja e provave është plotësisht e njëjtë në të gjitha lëndët. Vetëm ngastrat kadastrale, objekte të së drejtës pronësore të cilat pretendohen në secilën kërkesë, janë të ndryshme. Ankesat bazohen në deklaratën e njëjtë sqaruese dhe në dokumentacionin e njëjtë. Për më shumë edhe arsyetimi ligjor i dhënë nga ana e Komisionit për kërkesat është i njëjtë.
17. Ankesat e regjistruara me numrat GSK-KPA-A-146/14, GSK-KPA-A-147/14 dhe GSK-KPA-A-148/14 bashkohen në një lëndë të vetme me numrin GSK-KPA-A-146/14.

Juridiksioni i KKPK-së

18. Në përputhje me nenin 3.1 të Ligjit 03/L079, KKPK-ja ka kompetencë për zgjidhjen e kërkesave që ndërlidhen me konfliktin që përfshijnë rrethana që ndërlidhen drejtpërdrejtë me apo rezultojnë nga konflikti i armatosur që ndodhi në Kosovë ndërmjet 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999. Prandaj, paraqitësi i kërkesës duhet të paraqes jo vetëm titullarin e pronësisë mbi pronën e paluajtshme private por edhe të dëshmojë se ai apo ajo tani nuk është në gjendje t'i ushtrojë ato të drejta pronësore për shkak të rrethanave që ndërlidhen drejtpërdrejtë me apo rezultojnë nga konflikti i armatosur.
19. Sipas KKPK-së, pala përgjegjëse në ankesë dorëzoi një Aktgjykim të vitit 1966 me të cilin e drejta e pronësisë mbi pronën e kërkuar i ishte bartur gjyshes së palës përgjegjëse në ankesë.

20. E drejta e pronësisë fitohet sipas vetë ligjit, në bazë të veprimit juridik (transferit juridik) dhe me trashëgim, në përputhje me nenin 20 të Ligjit për Marrëdhëniet Themelore Juridike Pronësore (GZ RSFJ, Nr. 6/1980), në fuqi në vitin 1996, koha kur kishte ndodhur transferi i pretenduar i pronës së kërkuar.
21. KKPK-ja bëri verifikim pozitiv të Aktgjykimit të lartcekur nr.44/95 të marrë nga Gjykata Komunale në Kuršumli më 25 mars 1996.
22. Neni 33 i Ligjit për Marrëdhëniet Themelore Juridike Pronësore (GZ RSFJ, Nr. 6/1980) përcakton se në bazë të veprimit juridik (që është Aktgjykimi në këtë rast), e drejta e pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme fitohet me regjistrimin në librin publik (librin kadastral) ose në mënyrën tjetër përkatëse të caktuar me ligj.
23. **Megjithatë, regjistrat kadastral në Kosovë nuk ishin azhurnuar në emër të gjyshes së palës përgjegjëse në ankesë apo trashëgimtarëve të saj.** Kjo do të thotë se Aktgjykimi nr.44/95 i marrë nga Gjykata Komunale në Kuršumli më 25 mars 1996 nuk ishte ekzekutuar asnjëherë.
24. Më 22 korrik 2016, Gjykata Supreme lëshoi një urdhër gjykate drejtuar Zyrës Kadastrale të Komunës së Podujevës duke i kërkuar të tregojë nëse ngastrat me numrat 231, 232 dhe 233 janë bashkuar në një ngastër të vetme me numër 235 dhe që të jep informata se cila është baza ligjore për këtë veprim. Sipas përgjigjes të datës 30 shtator 2016, **me aprovim paraprak të Administratorit Komunal të emëruar nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të KB-së në Kosovë, i cili ishte përgjegjës për administrimin e Pronës Shoqërore dhe Publike, dhe Vendimin e Kuvendit Komunal të Podujevës nr.02-01/264-953 të datës 20 dhjetor 2001, prona e kërkuar i ishte dhënë për shfrytëzim të përkohshëm klubit futbollistik “Besiana” në Podujevë,** disa njësi kadastrale (duke i përfshirë ngastrat e lartcekura 231, 232 dhe 233) ishin bashkuar në një sipërfaqe të përgjithshme prej 88611 m² dhe nga kjo sipërfaqe ishte krijuar ngastra me numër 235-0, me sipërfaqe prej 40000 m², me kulturë livadh, kategoria 2, dhe 4 ngastra tjera. Ngastra e re nr.235-0 ishte krijuar nga këto njësi të vjetra kadastrale (ngastra): Nr.235, 231, 232, 233, 237, 238-1, 2, 3, 239-2 dhe 240 në zonën kadastrale Livadicë.
- Më 10 shtator 2002, ngastra kadastrale nr.235-0 ishte regjistruar nga statusi i mëparshëm me pronarin e vjetër Kooperativa Bujqësore Podujevë, pas Vendimit të lartcekur të Kuvendit Komunal të Podujevës nr.02-01/264-953 të datës 20 dhjetor 2001, në statusin e ri që është pronë shoqërore dhe me shfrytëzues klubi i futbollit “Besiana” për periudhën prej 10 vitesh. Më 28 shtator 2011, Vendimi i Kuvendit Komunal të Podujevës nr.02-

- 01/264-953 të datës 20 dhjetor 2001 për Ndarjen e Pronës Komunale për shfrytëzim të përkohshëm klubit të futbollit “Besiana” ishte anuluar nga Kuvendi Komunal i Podujevës dhe aktualisht ngastra nr.235-0 është e regjistruar si Pronë Komunale.
25. Në bazë të lartcekurave, Gjykata arriti në konkludimin se gjyshja e palës përgjegjëse në ankesë nuk e kishte fituar të drejtën e pronës pasi që nuk ishin përmbushur kushtet e nenit 33 të Ligjit për Marrëdhëniet Themelore Juridike Pronësore (RSFJ, Nr. 6/1980). Si rrjedhojë, as Vendimet për Trashëgimi të përmendura në paragrafin 3 të Aktgjykimit nuk duhet të merren parasysh, pasi që nuk ishte vërtetuar e drejta e pronësisë e gjyshes së palës përgjegjëse në ankesë.
 26. Gjykata Supreme konsideron se nuk ka pasur pengesa as juridike as praktike që të mos azhurnohen librat kadastral në Kosovë në përputhje me Aktgjykimin, duke pasur parasysh se ai ishte lëshuar në vitin 1996.
 27. Megjithatë, faktet e vërtetuara e çojnë Gjykatën në konkludimin se kontesti lidhur me pronën në fjalë nuk buron nga konflikti i armatosur i viteve 1998/99. Kontesti daton që nga viti 1967, kur prona e familjes së palës përgjegjëse në ankesë ishte konfiskuar dhe marrë nga Kooperativa Bujqësore “Sloga”.
 28. Gjykata Supreme konkludon se Komisioni ka vendosur gabimisht dhe jo ligjërisht kur e mori vendimin e ankimuar, pasi që ai nuk kishte juridiksion mbi kërkesën. Prandaj, pranohen ankesat e palës ankuese, anulohet vendimi i KKPK-së dhe kërkesat hidhen poshtë në përputhje me nenin 13.3 (a) të Ligjit nr. 03/L-079.
 29. Në bazë të lartcekurave dhe në përputhje me nenin 12.2 të Ligjit nr. 03/L-079 dhe nenin 195.1 (e) të Ligjit për Procedurën Kontestimore, është vendosur sikurse në dispozitivin e këtij Aktgjykimi.
 30. Ky aktgjykim nuk e paragjykon të drejtën e palëve që të kërkojnë të drejtë ligjore mbi pronën para gjykatave kompetente në Kosovë.

Këshillë ligjore

Në përputhje me nenin 13.6 të Ligjit 03/L-079, ky Aktgjykim është i formës së prerë dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të zakonshme apo të jashtëzakonshme juridike.

Beshir Islami, Kryetar i Kolegjit

Krassimir Mazgalov, Gjyqtar i EULEX-it

Ragip Namani, Gjyqtar

Bjorn Olof Brautigam, Referent i EULEX-it